

JETA E TË LUMIT ALANO I RUPES

e treguar me ilustrime



Centro Studi Rosariani, Romë, 2015

JETA E TË LUMIT ALANO I RUPES E TREGUAR ME ILUSTRIME

**NËN KUJDESIN E:
DON ROBERTO PAOLA**
(tekste të marra lirisht nga veprat e të Lumit Alano i Rupes)

VIZATIME NËN KUJDESIN E: LETIZIA ALGERI - ELENA BIA



Centro Studi Rosariani, Romë, 2015

PARATHËNIE

Libri i ilustruar lind nga ideja për t'u treguar në mënyrë të kuptueshme të gjithëve, jetën e të Lumit Alano i Rupes dhe Vizionet e tij Madhështore të Zojës së Rruzares së Shenjtë.

Libri me ilustrime paraqet një zgjedhje nga më të rëndësishmet e Vizioneve të Zojës së Rruzares së Shenjtë Shën Domenikut të Guzman (1170-1221p.K) dhe të Lumit Alano i Rupes (1428-1475 p.K), që i Lumi Alano tregoi në shkrimet e tij dhe që do t'i kishin dhënë jetë, pak vite pas vajtjes në Qiell, librit të parë të Rruzares së Marisë që ai e quante "Psalteri i Jezusit e Marisë".

Libri i Rruzares solli në Kishë një zjarr të ripërtërirë, në të gjithë Kishën, përmes recitimit të Rruzares së Shenjtë dhe lulëzimin e Vëllazërive të Rruzares falë veprës së jashtëzakonshme të domenikanëve, mbrojtësit e parë Rruzares së Shenjtë, që nga fillimet e saj.

Libri ka filluar në vitin 2014 nga Elena Bia, që është ndalur pak në jetën e të Lumit Alano i Rupes; dhe ka vazhduar në 2015 nga Letizia Algeri që është ndalur në mënyrë të posaçme mbi Vizionet e Zojës së Rruzares Shën Domenikut dhe të Lumit Alano dhe mbi shembujt e Rruzares.

Teksti, në mënyrë të lirë është pjesë e veprave të të Lumit Alano i Rupes dhe në trillim letrar është treguar në vetën e parë nga vetë i Lumi Alano.

Libri i ilustruar, si edhe librat e tjerë të serisë "Studia Rosariana", mund të shkarkohet falas, por jo të botohet për arsye fitimi (nëse do të printohet në vazhdim do të ketë GJITHMONË vetëm çmimin e kostos së punës): dëshiroj që AS TANI AS KURRË të ketë të drejta autori, ose tregtim me qëllim fitimi të këtyre thesareve të botës shpirtërore katolike që na janë dhuruar nga Virgjëra e Rruzares së Shenjtë dhe nga Këngëtari i saj, i Lumi Alano për shpëtimin tonë, pra këto shkrime u përkasin të gjithëve.

Të jetë gjithçka për lavdinë e Mbretëreshës së Rruzares së Shenjtë dhe të Këngëtarit të saj të shkëlqyer në tokë dhe në Qiell, të Lumit Alano i Rupes.

*Roma, 13 janar 2015, tetëditëshi i Epifanisë,
XVIII vit nga fillimi i Veprës Rruzariane,
Don Roberto Paola*

TREGUESI

PARATHËNIE.....	3
Kap. I: 1428 p.k.....	8
PLOUER SUR RANCE: FILLIMET E JETËS DHE THIRRJA E ALANO I RUPES.....	8
Kap. II: rreth 1440-1443 p.K.....	16
NISJA PËR DINAN.....	16
Kap. III: 1454 p. K.,.....	19
DINAN: SHUGURIMI PRIFTËROR.....	19
Kap. IV: 1457 p.K.....	21
MËSIMDHËNIA NË PARIS	21
Kap. V: 1467-1464:	22
SHTATË VITET E ERRËTA	22
Kap. VI: DOUAI, 1464,	25
BETEJA PËRFUNDIMTARE QË PARAPRIU VIZIONET E ZOJËS SË RRUZARES SË SHENJTË	25
Kap. VII: 1464 p.K.,.....	30
DOUAI: VIZIONI I PARË I ZOJËS SË RRUZARES NË KISHËN E NOTRE DAME.....	30
Kap. VIII: 1464 p.K.,	34
DOUAI: VIZIONI I DYTË I ZOJËS SË RRUZARES NË KUVENDIN E KISHËS SË NOTRE DAME:	34
KUPA E QUMËSHTIT TË SAJ AMËNOR,	34
KURORA E RRUZARES NË QAFË	34
DHE UNAZA E MARTESËS SË TYRE MISTIKE	34
Kap. IX.....	41
SHFAQJA E ZOJËS SË RRUZARES SHËN DOMENIKUT NË TOLOZË TË FRANCËS, NË 1212	41
Kap. X.....	52
VIZIONET MISTIKE NGA 1464 DERI MË 1475	52
Ndërsa lusja Rruzaren.....	53

Kap. XII:	100
VIZIONI I VËLLAZËRISË	100
SË RRUZARES	100
Cap. XIV	110
SHEMBUJT E RRUZARES TË TREGUARA	110
NË VËLLAZËRI	110
Shembulli i Kryediakonit Adrian që Rruzarja e ngre nga rënia e tij tragjike. .	110
Shembulli i mësuesit të shkollës, i liruar në mënyrë të jashtëzakonshme nga burgu, falë Rruzares së Virgjëres së Lavdishme	111
Shembulli i ushtarit të pamposhtshëm breton	112
Shembulli i një lpushkvi, që kishte hyrë në herezinë e albigezëve, që kthehet falë Rruzares së Marisë	113
Shembulli i Xhakomos, fajdexhiu	114
Shembulli i kthimit të mrekullueshëm të paganit Eliodato, falë Rruzares së Virgjëres së Lavdishme Mari	115
Shembulli i Alanit, ushtar i devotshëm breton	116
Shembulli i Kontit Bartolomeo të Italisë	117
Shembulli i Kardinalit të devotshëm të Rruzares	118
Shembulli sesa i dobishëm është vetëm ta mbash Rruzaren e Virgjëres Mari	119
Shembulli i Rev. Atë, Fra Pietrit, Epror certozin	120
Shembulli i Shfaqjes së mahnitshme të Virgjëres Mari mua, Alanit të Rupes, Dhëndrit të saj të ri	121
Shembulli i Murgut të bërë papritur i ditur	122
Shembulli sesa është e dobishme të lusësh Rruzaren e Virgjëres së Lavdishme, duke përdorur ndëshkimin trupor	123
Shembulli mbi Rruzaren që të bën të fitosh Qytetin e Qiellit	124
Shembujt e shkurtër të lutjeve “Ati ynë dhe Të falemi Mari”	125
Shembulli i Baronit Pietër	126
Shembulli i Kontit keqbërës të Francës, të kthyer nga forca e Rruzares së Virgjëres Mari	127

Shembulli i kthimit të një Fisniku dorëlëshuar	128
Shembulli i Rruzares që shpëton një pirat nga një djall, në formën e një shtëpiaku	129
Shembulli i Vëllait laik, që recitonte vetëm lutjen “Të falemi Mari”.....	130
Shembulli i Princit Alfonso	131
Shembulli i mrekullisë së Katerinës së bukurës, romane	132
Shembulli i pasqyrës së mëkatares Benedeta, nga Firenze	133
Shembulli i Benedetes, nga Spanja	134
Shembulli i virgjëres Aleksandra.....	135
Shembulli i fisnikes Luçia, nga Spanja.....	136
Shembulli i Marisë, Konteshë e Spanjës.....	137
Shembulli i Murgeshës së klauzurës, dhe të Manastirit të reformuar, falë Rruzares.....	138
Shembulli i Elenës, grua e përdalë e Anglisë, që kthehet, falë Rruzares së Virgjëres Mari	139
Shembulli i shembullit të paharrueshëm të Konteshës Domenika.....	140
Shembulli sesa fitimprurës është për gratë e martuara të lusin Rruzaren e të Lumes Virgjëres Mari	141
Shembulli i virgjëres së bërë copë-copë nga një ujk	142
Shembulli i tre motrave, që vdiqën në mënyrë të shenjtë.....	143
Shembulli i Italikes Mari, që nuk donte të luste Rruzaren dhe të bënte pjesë në Vëllazëri.....	144
Shembulli i Murgeshës së devotshme, falë lutjes “Të falemi Mari”	145
Kap. XV: 1471 p.K.,.....	146
ROSTOCK, DOKTORATURA DHE MËSIMDHËNIA.....	146
Kap. XVI:	147
MUAJT E FUNDIT TË JETËS: QERSHOR 1475	147
TAKIMI NË TOURNAI ME.....	147
IPESHKVIN FERRIKO DHE.....	147
DORËZIMI I APOLOGJISË SË RRUZARES	147
Kap. XVII	149

ZWOLLE, 15 GUSHT 1475	149
KËNGA E MJELLMËS.....	149
Kap. XVIII:.....	150
VIZIONI I NGJITJES NË QIELL TË MARISË DHE TË FILLIMIT TË PERANDORISË SË SAJ TË MËSHIRËS	150



THIRRJA E ALANO I RUPES

(ilustrimet e Elena Bia)

Dua të tregoj mrekullitë që Jezusi dhe Maria kanë bërë për mua: dhuratën e mrekullueshme të jetës, dhuratën akoma më të shkëlqyer të Thirrjes për Prift, dhe Thirrjen sublime brenda Thirrjes, për të qenë i zgjedhur, pikërisht unë, kaq i vogël nga vetë Zoja e Ruzares të jem i pari Këngëtar i Ruzares dhe i Vëllazërisë së saj.

Në Librin e Ruzares quhem “Dhëndri i ri i Marisë”, por emri im është Alano i Rupes (në histori ka mbetur vetëm emri si fetar), dhe kam lindur në Plouer-sur-Rance, të Rajonit të Bretanjes franceze, në 1428 pas Krishtit.

Kam pasur hirin të marr Thirrjen nga Zoti që nga çasti i parë i jetës: në fakt, kujtimet e para që kam nga jeta ime, janë të lidhura me dëshirën për t’u bërë një ditë Prift.


Vij nga familja fisnike De la Roche; megjithatë nuk më pëlqente të merrja pjesë në turnetë e luftës, as të bëja stërvitje dhe të kalëroja, por vetëm të rrija në Kishë dhe të kundroja Tabernakulin e mbuluar nga mbulesa, në të cilin rrinte Zotëria jonë Jezu Krishti dhe mbi Altar shikoja i dalldisur tablone ku Zoja i dorëzonte Ruzaren Shën Domenikut.

Sapo dilja nga Kisha e vogël, më pëlqente të përkëdhelja petalet e buta e të bardha, të kuqe e të verdha të trëndafilave në lulëzim, dhe të rrija ndenjor përgjatë murit rrethues të Kështjellës dhe të admiroja lumin Rance, në pikën e grykës, ku ujërat e tij dukeshin sikur bashkoheshin me qiellin, dhe ku e gjelbra e fortë e natyrës së egër mbushte me jetë brigjet e panumërta përreth.



Plouër-sur-Rance është një fshat i vogël, i ngritur mbi lumin Rance: ato pak shtëpi që janë, kanë në qendër Famullinë e Shën Pjetrit, ku jam pagëzuar i porsalindur dhe që ruan eshtrat e prindërve të mi.

Poshtë fshatit, përgjatë brigjeve të Rance, një Shenjtërore Mariane ruan akoma një statujë timen.






Nga Kështjella e vjetër kanë mbetur kullat rrethuese dhe dhomat e katit përdhes të Kështjellës, pjesa më e madhe e të cilave janë të varrosura poshtë livadhit të madh të Vilës aktuale De la Roche.

Ndodhi që në këtë Kishë të vogël, që ishte pjesë e Kështjellës, që fëmijë dëgjova qartë brenda vetes Zërin e Zotit që më thërriste për ta ndjekur në udhën e Priftërimit në Urdhërin Domenikan.

Kujtimi i ëmbëlsisë së atij Zëri më ka shoqëruar për të gjithë jetën.



Qëndroja i magjepsur përpara tabllës së Zojës së Ruzares që i dorëzonte Shën Domenikut Ruzaren.

Ishin fretërit domenikanë që ia dhuruan Kishës së Kështjellës së familjes, ku çdo mëngjes, në agim, çonin Meshën e Shenjtë për familjen time dhe për personelin e Kështjellës.

Ata më tregonin shpesh historitë e vjetra të Zojës së Ruzares: si Ajo, në 1212, në një kohë konfuzioni të madh brenda Kishës, për shkak të herezisë së albigjezëve, i dorëzoi Shën Domenikut të Guzman një Kurorë të Ruzares së Shenjtë prej 150 Trëndafilash dhe 15 Zambakësh, të quajtur për këtë arsye

Rosario (Ruzare), me këtë Premtim: “Zoti filloi shpëtimin e botës me lutjen “Të falemi Mari”; ki besim Domenik, lutu dhe përhap Ruzaren: gjithçka që do të kërkosh në Ruzare, do ta fitosh”.

Dhe, përmes Shën Domenikut, Zoja e Ruzares mbolli mbi tokë dy mjete të mëdha shpëtimi: Urdhërin Domenikan dhe Vëllazërinë e Ruzares: të dy për përhapjen e promovimin e Ruzares së saj.



Më dukej sikur kisha lindur vetëm për një qëllim: doja të kushtoja jetën time në shërbim të Jezusit e të Marisë dhe dëgjoja në zemër që doja t'i përkisja Urdhërit të lavdishëm Domenikan, për të përhapur në të gjithë botën Rruzaren dhe Vëllazërinë e saj të lavdishme që ishte në kohën time pothuajse krejt e harruar.



Një ditë, nëna ime, ndërsa po lutesha në Kishë më tha: “Biri im ndej në zemër që Jezusi dhe Maria kanë projekte të mëdha për ty”!

I buzëqesha dhe i thashë se më shpërthente zemra nga gëzimi, prej mendimit që një ditë do të ngjitesha në Altarin e Shenjtë dhe do të celeburoja Misteret Hyjnore të Meshës së Shenjtë dhe do t’i ngrija Marisë lavdet Hyjnore, me Psalterin e Kurorës së Rruzares.



Isha tashmë 12 vjeç dhe më rrihte zemra fort nga mendimi që së shpejti do të hyja në Rishtarët e Dinanit, por e zgjasja ditë pas dite, sepse më mbanin lidhjet e shtëpisë dhe në mënyrë të posaçme lidhja me nënën time.

Një mëngjes u zgjova kaq i lumtur, thirra nënën dhe i thashë: “Nënë, sonte kam parë një ëndërr shumë të bukur! Që Rance kishte përmbytur fushën dhe uji rritej gjithnjë e më shumë. Dhe unë i veshur me veshjen domenikane ndërtoja një urë të varur me 150 shtylla dhe shpëtoja nga uji shumë persona të popullit, dhe i bëja të shkonin përmes urës së vogël mbi një kodrinë, ku ishte e ulur mbi fron Zoja e Ruzares, me Jezusin Fëmijë në krahë dhe ajo u buzëqeshte atyre, dhe i jepte secilit nga një kurorë me Trëndafila dhe Zambakë!

Nëna më shikoi me sy të përlotur dhe tha: “Biri im, edhe unë sonte kam parë një ëndërr të tillë: gjendesha në rrëzën e një mali shumë të lartë dhe ujërat e lumit Rance ishin rritur shumë. Duke ngritur sytë nga qielli shikoja Zojën e Ruzares në majë të malit, dhe ti dhe Shën Domeniku që ishit pranë saj, e ndihmonit që të nxirrte shumë persona nga uji, përmes një Zinxhiri me 150 Unaza të arta, si një Kurorë e madhe Ruzareje.

Është një shenjë hyjnore, biri im, nëse ndjen në zemrën tënde që Jezusi, Zoja e Ruzares dhe Shën Domeniku po të thërrasin në Urdhërin Domenikan, ndiq zemrën tënde!

Largimi yt më trishton shumë, sepse ti je shpirti i kështjellës, por unë do të të ndjek gjithmonë në Meshën e Shenjtë dhe në Ruzaren e Shenjtë”.

Nëna më dha një puthje dhe u përqaftua me dashuri, dhe në atë moment pata sigurinë që Jezusi dhe Zoja po më prisnin në Rishtarët e Dinanit.

Kap. II: rreth 1440 – 1443 p.K.:

NISJA PËR DINAN



U pranova në Rishtarët Domenikanë të Dinanit dhe u përgatita për nisjen: Dinani ishte 10 km nga shtëpia ime.

Qava shumë kur u nisa dhe kur lashë prindërit e mi dhe vëllezërit, miqtë, livadhet e gjelbra të shtëpisë sime dhe skenarët e magjishëm e të kaltër të Rance dhe të qiellit, por më shumë për të shkëputurit nga nëna ime e shtrenjtë, ajo që më kishte mësuar të doja Jezusin në Eukaristi dhe Zojën e Rruzares, duke recituar çdo ditë Kurorën e saj.

Një mëngjes pranvere, u nisa drejt Dinanit, qytet mesjetar i një bukurie të rrallë dhe sapo kalova Portën e vjetër u ndala për t'u lutur në Kishën e Saint Sauveur (që akoma ruan një imazh timin në një xham të Kishës), dhe arrita shpejt tek Rishtarët Domenikanë.



Nuk mund ta përshkruaj gëzimin e pafund, të papërcaktueshëm, pa fund, që ndjeva, kur u hapën për mua dyert e Rishtarëve të Dinanit: sapo hyra në Kishë dëgjova një melodi magjepsëse dhe qiellore, megjithëse në Kishë nuk kishte asnjëri: isha i magjepsur, Kori i Engjëjve dukej sikur më bënte festë.

**Kap. III: 1454 p.K.,
DINAN: SHUGURIMI PRIFTËROR**



Vitet e Rishtarisë kaluan shpejt, dhe erdhi dita e madhe e Shugurimit Priftëror: familja ime zbriti nga Plouër-sur-Rance, dhe u gëzuan së bashku për hirin që Zoti i kishte dhënë familjes sonë.

Pashë familjen tashmë të rritur: erdhën në Shugurimin tim babai dhe nëna, vëllezërit dhe motrat tashmë të gjithë të martuar, me fëmijët e tyre, dhe shumë miq të fëmijërisë dhe të personelit të kështjellës, për t'u gëzuar së bashku me mua.

Bashkë me gëzimin pati edhe lot të lamtumirës, kur u thashë atyre që eprorët e mi më kishin caktuar në Paris, ku do të shkoja për t'u specializuar në mësimdhënien e Telogjisë së Shenjtë.

Po hapej një kapitull i ri në jetën time dhe çdo ndryshim më trembte jo pak.



Nëna, duke më parë të shqetësuar për nisjen, më tha: “Mos ki frikë biri im, për atë që do Zojën dhe e përshëndet me Rruzaren e saj, çdo ditë do të jetë gjithmonë e më mirë, zemrat tona do të jenë të bashkuara në Krishtin dhe në Marinë përgjithmonë”!

Kap. IV: 1457 p.K.:

MËSIMDHËNIA NË PARIS



Çfarë mrekullie Parisi!

Nuk kisha parë kurrë një qytet të madh.

Kuvendi dhe shkolla jonë (Sorbona) nuk ishin larg nga Kisha e Notre Dame, mbeta pa frymë duke e parë në madhësinë e saj.

Në Paris përfundova studimet e specialitetit dhe mora detyrën e Profesorit të Teologjisë për studentët e bakalaureatit, domethënë të viteve të para të studimit.



Duhej t'u mësoja Gjykimet e Pietro Lombardit, teologu më i shkëlqyer i mesjetës.

Kap. V: 1457-1464:

SHTATË VITET E ERRËTA



Një mëngjes të vitit 1457, papritur ndjeva sikur ishte shuar në shpirtin tim drita e besimit.

Një ndjenjë e tmerrshme, sepse besimi ishte drita e buzëqeshjes sime dhe e jetesës sime: shikoja përpara, por shihja vetëm errësirë.



Zoti lejoi që djalli të më tundonte për shtatë vite shumë të gjata: nëse nuk do të kisha pasur mbështetjen e Meshës së Shenjtë dhe të Kurorës së Ruzares do të isha rrëmbyer nga tërbimi i të keqit.



Mundohesha të jetoja me zell dhe përkushtim lutjen dhe mësimin, por në brendësi ndjeja sikur Jezusi dhe Maria më kishin braktisur në fatin tim.

Dhe të mendosh që dikur unë isha më i gëzuari i shoqërisë.

BETEJA PËRFUNDIMTARE QË PARAPRIU VIZIONET E ZOJËS SË RRUZARES SË SHENJTË



Në vitin 1461 Eprorët më besuan, përveç mësimdhënies, detyrën e ndjekjes së Kongregacionit të Hollandës, domethënë rivendosjen e Respektimit të Rregullit Domenikan në disa Manastire dhe u dërgova për ca periudha në Lille dhe në Douai. Qenë vite tundimesh të rënda për mua.





Në 1464, ndërsa gjendesha në Douai për projektin e Kongregacionit të Hollandës, sulmet e demonit u bënë të përsëritura dhe të rrezikshme, dhe trishtimi më çoi të isha i pakujdesshëm në çuarjen e Meshës së Shenjtë dhe në recitimin e Rruzares.

Sulmet e djallit u bënë kaq ngulmuese, sa që do të më kishin shtyrë drejt dëshpërimit, nëse Virgjëra Nëna e Hyjit, e prekur në zemër, nuk do të më kishte ardhur shumë shpesh në ndihmë.





Nganjëherë forca e errët e torturuesit të tmerrshëm ishte kaq e pandalshme, saqë isha i shtyrë nga shpirti i dëshpërimit t'i jepja vetes në mënyrë të dhunshme vdekjen, duke e shkaktuar me duart e mia, duke derdhur frymën jetësore dhe gjakun tim me një thikë, ose duke u vetëvrrarë me çfarëdo lloj tjetër vdekjeje.






Kur, për fat të keq, në një moment dëshpërimi, unë çova dorën tek thika, duke e nxjerrë nga këllëfi...



Pa e kuptuar rëndësinë e veprimit, drejtova krahun drejt vetes, duke ngritur thikën e mprehtë në fyt, me një goditje kaq të vendosur dhe direkte, sa sigurisht do të kishte prerë krejt fytin, duke më shkaktuar vdekjen e menjëhershme...


Kap. VII: 1464 p.K.,

DOUAI: VIZIONI I PARË I ZOJËS SË RRUZARES NË KISHËN E NOTRE DAME.



Dhe ja, m'u shfaq papritmas e Dashura Mari, e cila erdhi në ndihmën time, dhe me gatishmëri më kapi krahun, duke më penguar veprimin e marrë që po bëja...





Dhe, duke më dhënë një shuplakë më tha: “Çfarë bën o i palumtur? Nëse ti do të më kishe kërkuar Ndhmë, siç ke bërë edhe herët e tjera, nuk do të kishe rënë në një rrezik kaq të madh”!

Sapo tha këtë u zhduk dhe unë mbeta vetëm.



Pak kohë më pas, u godita nga një sëmundje e rëndë dhe e pashërueshme e trupit, aq sa të gjithë ata që më njihnin ishin të sigurt që unë isha biri i ardhshëm i vdekjes.

Ndërsa isha i shtrirë në krevat, i dëshpëruar, qaja me dënesë, lutesha dhe thërrisja Virgjëren Mari, me këto fjalë: “I shkreti unë, ndihem kaq afër vdekjes! I mjeri unë! Pse jam kaq pa fat? Pse Qielli është kaq kundër meje? Pse Qielli është kaq mizor me mua? Ferri më persekuton; njerëzit më braktisin. Nuk di çfarë të mendoj më, as çfarë të them, as ku të drejtohem. Ndihesha kaq i fortë e kaq i sigurt, o Mari, për Ndihmën tënde, ndërsa ja, jam kaq i mjerë! Çfarë hidhërimi! Jam i shtypur nga një mallkim i tmerrshëm...




**...I mjeri unë! Për çfarë arsyeje kam lindur? I shkreti unë, për çfarë arsyeje kam parë dritën? Pse kam hyrë në këtë Urdhër Fetar dhe pse jam shuguruar? Pse thirrja më ka caktuar një shërbim kaq të rëndë dhe të gjatë? Ku është, atëherë, e vërteta e fjalëve të atij që tha: “Zgjedha ime është e butë dhe ngarkesa ime është e lehtë”? Ku është e vërteta e fjalëve, që Ai nuk na lejon ne të jemi të tunduar më shumë sesa mundemi të mbajmë”?
Dhe ja, papritur më erdhi në ndihmë Shenjtja Mari.**


Kap. VIII: 1464 p.K.

**VIZIONI I DYTË I ZOJËS SË RRUZARES NË KUVENDIN E KISHËS
SË NOTRE DAME:**

**KUPA E QUMËSHTIT TË SAJ AMËNOR, KURORA E RRUZARES NË
QAFË DHE UNAZA E MARTESËS SË TYRE MISTIKE.**



Ndërsa luftoja mes gjendjeve të ndryshme të shpirtit, dhe isha i prirur herë nga njëra, herë nga tjetra gjë, gati në mes të natës dramatike, midis orës dhjetë e njëmbëdhjetë, në qelinë aty ku isha i shtrirë, shkëlqeu papritur një dritë qiellore me një shkëlqim të pamasë, dhe në të u shfaq madhështore e Lumja Virgjëra Mari, që më përshëndeti ëmbëlsisht.




E Bekuara Virgjëra Nëna e Hyjit më vari në qafë një Kurorë të Ruzares, të bërë nga Flokët e saj të Virgjër, mbi të cilën ishin të fiksuar 150 Gurë të çmuar, të ndarë në 15 dhjetëshe, sipas numrit të Ruzares së saj.



Pas shumë bisedash të shenjta, Zoja e ëmbël më dha një puthje dhe më dha të pija Kupën e Qumështit të saj Amënor. Unë e piva me shumë nderim dhe më dukej se më në fund kisha arritur paqen dhe isha ngritur drejt Qiellit.


Dhe, menjëherë u shëruan plagët e shumta vdekjeprurëse të demonëve.



Në të njëjtën kohë, në praninë e Zotit tonë Jezu Krisht dhe të tre Mbretëreshave të Ruzares, që i rrinin përreth, Maria më deshi si Dhëndër të ri të saj në Martesën Mistike...



...dhe më vuri në gisht Unazën e Martesës sonë Mistike, të bërë nga Flokët e saj të Virgjër.



Nga ai moment unë ndihesha mrekullisht i ndihmuar, kundër çdo tundimi djallëzor.



Pasi kreu këto, Zoja më tha që do t'u bënte po ashtu, në mënyrë shpirtërore dhe jo të dukshme, atyre që do të recitonin me devotshmëri Rruzaren e saj. Dhe që atëherë, shumë shpesh, Nëna e Hyjit më bëri dhuratën e atij hiri që të pija Qumështin e saj Amënor.

Këto gjëra që tregoj janë të denja të admirohen nga të gjithë njerëzit.

Mbretëresha e Qiellit dhe e tokës, pas Martesës më tha: “Dhëndër i dashur, ti ke qenë në ankth kaq shpesh dhe ke qenë i pikëlluar kaq rëndë: po a e di pse? Kisha vendosur t'i jepja këto ëmbëlsi, për këtë, për shumë vite, të sillja ty gjëra të hidhura. Hajt, gëzohu tani! Ja, po të dhuroj nga plotësia e dhuratave të mia pesëmbëdhjetë Stoli, sikurse pesëmbëdhjetë janë Zambakët e Psalterit Virgjëror”.

I. Stolia e parë: Faljen përfundimtare të mëkateve; II. Shoqërinë time (të Marisë); III. Hirin për të fituar atë që do të kërkosh në Rruzare; IV. Ndhimën e Qiellit; V. Shoqërinë e Zotit; VI. Shoqërinë e Shenjtërve; VII. Mënyrën e të folurit të Shenjtërve; VIII. Njohjen e realiteteve qiellore; IX. Pafajësinë ndaj grave; X. Urtinë në të folur; XI; Shoqërinë e Jezu Krishtit.

Të dymbëdhjetin, të trembëdhjetin, të katërbëdhjetin dhe të pesëmbëdhjetin nuk i kam treguar: janë kaq sekret dhe të lartë, saqë nuk e quaj të drejtë t'ua manifestoj të vdekshmëve”.

Kap. IX:
SHFAQJA E ZOJËS SË RRUZARES SHËN
DOMENIKUT, NË TOLOZË TË FRANCËS, NË 1212.
(Ilustrime të: Letizia Algeri)



Zoja e Rruzares më bëri të shoh situatën e tmerrshme në të cilën gjendej Europa e shekullit të XIII: ishin duke lindur herezi të reja, dhe mes të gjithave, më e rrezikshmja ishte herezia e albigjezëve, që kishte lindur jo larg nga Toloza, në Albi: lëvizja në fillim ndiqte idealet e krishtera të varfërisë, por që nga fillimi gjarpëronte në të demoni i kryelartësisë.

Albigjezët, për faktin që bënë një rrugë me etapa, deri në etapën përfundimtare të quajtur Consolamentum, ndiheshin më të mirë se katolikët e tjerë, dhe ai që nuk kishte bërë të njëjtën rrugë, përçmohej dhe luftohej.

Kjo kryelartësi lindi herezinë: ata mbaheshin si të vetmit të krishterë dhe depozitues të së vërtetës, dhe filluan të vinin në dyshim doktrinën katolike mbi Sakramentet dhe mbi Eukaristinë në veçanti, deri në kundërshtimin e hapur të Papës dhe të Kishës.

Papa Inoçenzi III, për të qetësuar trazirat që goditnin katolikët në Europë, po bëhej gati të dërgonte një Kryqëzatë në Toloza, kur Zoja vendosi të ndërhynte me një dhuratë Hiri: Rruzaren e Shenjtë.

Dhe zgjodhi për këtë detyrë një Kanonik të rregullt të Katedrales së Osma, në mbretërinë e Kastiljes dhe Leonit në Spanjë, që gjendej kalimthi në Tolozë të Francës, Shën Domenikun.



Përpara kokëfortësisë së Katarëve apo të Albigjezëve, Domeniku i Guzman, në atë kohë prift i ri, i lodhur dhe i zhgënjyer, pasi kishte provuar të gjitha rrugët e predikimit për të afruar atë popull në Kishë, u tërhoq në një pyll, që ishte pak jashtë Tolozës, për t'u lutur.



Shën Domeniku u përkul në gjunjë në lutje, agjëronte dhe godiste veten si dënim për mëkatet e albigjezëve dhe i kërkonte vazhdimisht Zojës një lutje që mund të fitonte mbi të keqen e botës.



Një natë, më duket se ishte pikërisht nata mes 24 e 25 marsit 1212, shikova Patriarkun e Urdhërit Domenikan, vetë Shën Domenikun, ndërsa lutej dhe bënte dënimin në shpellë: ishte i zhgënjyer dhe i trishtuar për shkak të kokëfortësisë së albigjezëve dhe duke qarë fshikullohej me ferra dhe i kërkonte Zojës një lutje që mund të fitonte mbi të keqen, ÇDO TË KEQE.

Dhe shikoi, papritur, në një dritë flakëruese dhe të mrekullueshme, tek shfaqej Zoja e Ruzares, e shoqëruar nga tre Mbretëresha dhe pas secilës prej tyre kishte 50 Virgjëra.

Mbretëresha e parë kishte një veshje të bardhë, e dyta një veshje ngjyrë të purpurt, e treta një veshje të verdhë si ar.

Dhe si ato ishin të veshura Virgjërat që i ndiqnin.

Zoja e Ruzares ishte e veshur me një veshje të kuqe dhe me një mantel të gjelbër, dhe nuk mbante vellon në kokë (kështu sikur nuk e mbanin Mbretëreshat dhe 150 Virgjërat).

Zoja kishte sandale pelegrini në këmbë, ishte e ulur mbi një Fron, por dukej sikur donte të zbriste nga ai, për të ndihmuar mëkatarët e shkretë.

Kishte Jezusin Fëmijë në krahavor, dhe i tregoi Shën Domenikut një Kurorë të madhe, të bërë nga 15 Zambakë dhe 150 Trëndafila, 50 Trëndafila të bardhë, 50 Trëndafila të kuq dhe 50 Trëndafila të verdhë: ishte ajo lutja që Ajo i dorëzonte, që ai kishte kërkuar, lutja që mund të fitonte mbi çdo të keqe: Kurora e Ruzares së Shenjtë, Psalteri i Jezusit dhe i Marisë.



Tre Mbretëreshat dhe 150 Virgjërat simbolizonin Kurorën e Rruzares së Marisë së Shenjtë, që Ajo i dorëzoi Shën Domenikut, që t'ia dhuronte Kishës për shekujt e ardhshëm, dhe që Urdhëri Domenikan kishte detyrën ta ruante dhe ta promovonte, me dënimin që ky urdhër do të binte, nëse nuk do të bënte këtë.

Kurora e Rruzares e mernte forcën e saj nga Kurora Mbretërore dhe në Skeptrin e Marisë, Shenja e Komandës së Marisë mbi forcat e të keqit, që Ajo kishte fituar nga Hyji Ditën e Ngjitjes së saj në Qiell (unë këtë Ditë të Shenjtë, në të cilën Maria u ngjit në Qiell me Shpirt dhe me Trup, dhe mori nga Zoti titullin Mbretëresha e Qiellit dhe e tokës, dhe Kurorën Mbretërore dhe Skeptrin, e pashë në një Vizion që do të vijë më pas).


Kurorën e Rruzares, Ajo akoma më përpara se Shën Domenikut ua kishte dhuruar Murgjërve jeremitë, për të luftuar djallin.



**Pashë në Vizion që Zoja e Ruzares i tha Shën Domenikut:
“Si Hyji Atë filloi Shpëtimin e botës përmes lutjes “Të falemi
Mari”, kështu ti përhap gjithkund Ruzaren time: gjithçka që do
të kërkosh përmes Ruzares sime, do ta fitosh”!**



Në atë Natë të Shenjtë, i forcuar nga Fjalët të Marisë gjatë Shfaqjes së saj, Shën Domeniku u drejtua përsëri në sheshin e Katedrales së Tolozës së Francës, dhe ja, si hyri në shesh, këmbanat e Kullës së Katedrales tingëlluan kaq fort, saqë populli filloi të zbresë në rrugë dhe gjetën Shën Domenikun, që e njihnin tashmë për predikimet e tij, dhe ai, ndryshe nga herët e tjera, u propozoi atyre të lutnin Zojën, mes sharjeve dhe talljeve të tyre.



Dhe ja, papritur, shpërtheu një stuhi dhe një tërmet tronditi tokën e Tolozës, dhe qytetarët e Tolozës mbeten të pështjelluar.

Ndërkohë, Shën Domeniku i ftonte të ktheheshin dhe të pendoheshin, dhe u tregonte atyre Kurorën e Ruzares, por ata vazhdonin ta fyenin Shën Domenikun dhe të mallkonin...





... kur ja, u dëgjua një thirrje e përbashkët: statuja e gurtë e Zojës që qëndronte përpara Katedrales, papritur ngriti krahun drejt Qiellit, gati si një ftesë për t'iu drejtuar Marisë së Shenjtë, në mënyrë që Ajo të mund të ndërmjetësonte pranë Zotit!





Populli përpara kësaj Shenjeje Qiellore, ra për tokë duke qarë, dhe duke iu përgjëruar Shën Domenikut që t'iu mësonte atyre të lusnin Rruzaren.





Kishte ardhur agimi... tërmeti dhe shiu kishin pushuar dhe krahët e Statujës së Marisë ishin kthyer në vend: populli qëndronte akoma aty pa lëvizur, duke recituar Rruzaren me Shën Domenikun. Kishte lindur një botë e re, bota e Rruzarianëve!

Kap. X:


VIZIONET MISTIKE NGA 1464 NË 1475.



Ndërsa lusja Rruzaren...



...u rrëmbeva në shpirt dhe ndjeva që u bëra i ngjashëm me Krishtin, duke ndjerë mbi kokë Kurorën e tij me ferra, dhe në duar dhe në këmbë dhimbjen e shenjave të plagëve të Jezusit.



Dhe ja, papritur, gjendesha me Jezusin në një Pallat Mbretëror, dhe pashë një Vajzë me një Bukuri dhe Përulësi të papërshkrueshme (Marinë), dhe përballë saj, Kryeengjëllin Gabriel, që i thoshte: “Unë jam shërbëtorja e Zotit: më ndodhtë siç the ti”.

Vura re, atëherë, që sytë e mi ishin bërë më të ndritshëm se dielli dhe arrija të shihja që në Kraharorin e pastër të Virgjëres Mari ishte ngjizur, në çast, një Fëmijë, shumë i vogël në formë, i ngjashëm me një zog të vogël të porsalindur, i formuar tashmë në të të gjitha gjymtyrët.

Fëmija Jezus kishte në duar botën dhe dukej sikur fiksonte qytetin e Jeruzalemit, në të cilin Ai vuajti.



Shihja Fëmijën plot vuajtje, sikur po vuante që aty Mundimin.

Dhe Jezusi më tha: “Shiko si kam vuajtur tortura të vazhdueshme për ty dhe bijtë e Adamit, që nga fillimi i Ngjizjes sime, deri në momentin e vdekjes sime”!




Në atë çast, pashë Fëmijën Jezus të varur në një Pemë të madhe të Kryqit: spektakli ishte aq i dhimbshëm, sa që dukej sikur e lëvizte çdo krijesë tokësore dhe qiellore drejt Dashurisë ndaj të Kryqëzuarit.


Jezusi më tha: “Shiko sa gjëra kam vuajtur për ty”!

Iu afrova Pemës së Kryqit dhe vura re, pa kuptuar se në çfarë mënyre, që ai skenar i pamasë ishte i përmbajtur në të Lumen Virgjëren Mari, si në një Tempull.

Nga trangu i vetëm i kësaj Peme të pafund të Kryqit, degëzoheshin tre degë, dhe secila prej tyre ndahej në pesë degë, dhe në mes të tyre qëndronte i kryqëzuar Fëmija Jezus, i cili më tha që Mundimi i tij kishte filluar me lutjen “Të falemi Mari” që Kryeengjëlli Gabriel i tha Marisë.




Pas këtyre fjalëve, pashë shpirtra të pallogaritshëm, që nga bota tërhiqeshin në humnerë, nga demonë të panumërt dhe pashë Drejtësinë e Hyjit që qëndronte mbi një Kalë kuqalosh, që fluturonte me shpejtësi andej e këtej, për të shkretuar botën.



Atëherë Mëshira e Zotit më tregoi Ilaçet: lutjet e Ruzares për ndërhyrjen e Ndërmjetëses Mari, të cilës Zoti nuk i mohon asgjë.

Dëgjova atëherë një Zë Madhështor: “Sikur me lutjen “Të falemi Mari” Biri im ka shëlbyer botën, kështu me ndihmën e lutjes “Të falemi Mari”, të recituar nga Rruzarianët, dua të ndreq botën”.



Një ditë, ndërsa çoja Meshën e Shenjtë, pashë në Osten e Shenjtë, Jezusin të kryqëzuar dhe dëgjova që më thoshte: “Ti po më kryqëzon për të dytën herë”!

Dhe unë: “O Zotëri, si do të mundem vallë të bëj një krim kaq të tmerrshëm”?

Dhe Ai: “Mëkatet e tua më kryqëzojnë: dhe kur nuk më kryqëzon duke kryer mëkate, e bën me lënien pas dore. Ke përgatitjen, lirinë dhe detyrën e predikimit: ti je përgjegjës për të këqijat që mund të ndalosh, vetëm po të predikosh Rruzaren time. Por je bërë një qen i heshtur, i pazoti të lehësh, ndërsa bota është plot me ujqër”.



Pas këtyre fjalëve, ja, pashë të hapej krejtësisht një humnerë e pafundme, dhe në të gjendeshin shumë shpirtra, të torturuar nga bora, akulli dhe nga demonët në formë gjarpërinjsh. Dhe aty njoha shumë njerëz, që më përpara ishin në botën e të gjallëve.




Jezusi më tha: “Ja, ky do të jetë vendi yt i pushimit, nëse lë pas dore akoma predikimin. Shpalle Rruzaren time: të premtoj: Unë do të luftoj bashkë me gjithë Trupat Qiellore, kundër të gjithë atyre që do të të kundërshtojnë. Dhe jeto atë që predikon, me qëllim që ti të mos gjendesh një ditë në mes të këtyre që sheh, që thonin e nuk bënë”.

Kap. XI:
VIZIONI I SHËN DOMENIKUT I 15 PËRBINDËSHAVE TË
FERRIT DHE I 15 MBRETËRESHAVE TË VIRTYTEVE, TË
ZBULUAR NGA ZOJA TË LUMIT ALANO.



Pastaj, Zoja denjoi të më tregonte në Vizion një histori të mrekullueshme që i përket Shën Domenikut: Shën Domeniku në kthimin e tij nga Roma, ishte drejtuar për në Paris dhe duke kaluar për në Gjermani pati gjatë Meshës së Shenjtë një shfaqje të Zojës.



Zoja i tregoi Shën Domenikut një kështjellë, të banuar nga një ushtar trim dhe 14 oficerët e tij që kishin për gra 15 demonë të tmerrshëm të Ferrit, të maskuar si vajza shumë të bukura që pikërisht atë ditë do t'i kishin bërë të vdisnin në një përmbytje anijeje, për të dërguar shpirtat e tyre në Ferr.



Zoja i kërkoi Shën Domenikut të merrte me vete, në qafë, Osten e shuguruar, të mos bënte qendrëse kur kusarët e kështjellës do t'i afroreshin për ta vjedhur dhe t'u kërkonte atyre që ta çonin tek Princi i tyre. Dhe kështu ndodhi. Princi, pasi dëgjoji Shën Domenikun, nuk arrinte të besonte që ato vajza të mrekullueshme ishin demonë të Ferrit, prandaj Shën Domeniku i kërkoi që t'i thërriste ato për të demonstruar të vërtetën e asaj që ngulmonte, por ato, duke nxjerrë pretekste, nuk deshën të vinin.



Atëherë Shën Domeniku duke nxjerrë Osten e shuguruar tha: “Në Emër të Jezu Krishtit dhe për fuqinë e Ruzares ju urdhëroj të vini këtu”. Dhe ato u detyruan nga një forcë e misterhme të paraqiteshin dhe sapo panë Osten e Shenjtë filluan të shqetësoheshin dhe të përdridheshin të gjitha.



Atëherë Shën Domeniku mori në pyetje vajzën e parë dhe tha: “Të urdhëroj ty, bishë e kryelartësisë të flasësh”. Dhe ajo, duke përdredhur sytë tha se ishte e detyruar të tradhëtonte sekretin e tyre dhe të tregonte që ata ishin 15 shtriga dhe demonë të Ferrit dhe që ishin aty prej vitesh për të pritur momentin e duhur për të bërë që të humbnin përjetësisht Princi dhe oficerët e tij; dhe që deri tani nuk ia kishin dalë në qëllimin e tyre, sepse Princi, që fëmijë kishte zakon të luste “Këngën e asaj Gruas”, domethënë Rruzaren e Virgjëres Mari prej 15 Misteresh dhe i bënte edhe oficerët që ta recitonin. Por kishte ditë që nuk recitonin më Rruzaren për të përgatitur bagazhet për një inkursion dhe ato do t’i kishin bërë që të mbyteshin poshtërsisht dhe do t’i kishin çuar në Ferr.



Dhe Shën Domeniku tha: “Dhe tani, për t’u treguar të gjithëve kush jeni, o përbindësha të Ferrit, në Emër të Jezusit dhe për forcën e Rruzares, hidhni poshtë maskat”: dhe shpirti i atyre njerëzve ishte duke u shkëputur nga trupi, tek shikonin ato gra të transformoheshin në demonë dhe të rrokulliseshin në Ferr mes tymit dhe erës së qelbur. Pastaj, Shën Domeniku shpjegoi vizionin:



Bisha e parë e Ferrit është Luani i Kryelartësisë.



Bisha e dytë e Ferrit është Rojtari i Zilisë.



Bisha e tretë e Ferrit është Derri i Plogështisë.



Bisha e katërt e Ferrit është Përbindëshi i Zemërimit.



Bisha e pestë e Ferrit është Thithlopa e Kopracisë.



Bisha e gjashtë e Ferrit është Ujku i Grykësisë.



Bisha e shtatë e Ferrit është Cjapi i Fëlligështisë.



Bisha e tetë e Ferrit është Ariu i Mosbesimit.



Bisha e nëntë e Ferrit është Balena e Dëshpërimit.




Bisha e dhjetë e Ferrit është Zhgaba e Mendjemadhësisë.



Bisha e njëmbëdhjetë e Ferrit është Njëbrirëshi i Urrejtjes.



Bisha e dymbëdhjetë e Ferrit është Korbi i Paturpësisë.



Bisha e trembëdhjetë e Ferrit është e Përdala e Apostasizë.



Bisha e katërmbëdhjetë e Ferrit është Përbindëshi i Luftës.




Bisha e pesëmbëdhjetë e Ferrit është Dragoi i Pabesisë.




Pak kohë më pas, kur Shën Domeniku ishte në Bretanjë për të predikuar Ungjillin e Ruzaren, gjatë Shugurimit, në Meshën e Shenjtë, hyri në ekstazë dhe shikoi Zojën e Ruzares të shoqëruar nga 15 Mbretëreshat e Virtyteve: Zoja i tha që ato dëshironin që ne t'u luteshim atyre, për t'u bërë ato Mikeshat dhe Ndhmëset tona.




Mbretëresha e parë është Mbretëresha e Përvulësisë që ka në duar botën me në krye një Kryq.




E dyta është Mbretëresha Miqësi që ka në duar një tufë me Trëndafila me aromën e mirë të Miqësisë.




E treta është Mbretëresha e Gëzimit Shpirtëror që ka në duar një Zambak dhe Sytë të drejtuar nga Qielli.




E katërta është Mbretëresha e Durimit që mban mbi vete Zgjedhën e ëmbël dhe të butë të Krishtit.




E pesta është Mbretëresha e Mëshirës që i këndon himne Zotit me anë të Psalterit.




E gjashta është Mbretëresha e Abstinencës që ka Skeptrin e shkëputjes nga bota dhe një Psalter për t'i kënduar Zotit.




E shtata është Mbretëresha e Dëlirësisë që ka në kokë kurorën me Trëndafila dhe me Zambakë.




E teta është Mbretëresha e Kujdesit që mban në duar një gjarpër (pra e tejkalon zgjuarsinë e fjalëve të urta) dhe një pasqyrë (simbol i shqyrtimit të brendshëm ose i ekzaminimit të ndërgjegjes).




E nënta është Mbretëresha e Drejtësisë që ka me vete Peshoren e Paanësisë.




E dhjeta është Mbretëresha e Forcës që shtrëngon Heshtën dhe Mburojën shpirtërore.



E njëmbëdhjeta është Mbretëresha e Besimit që ka në njërin dorë Kryqin e Krishtit dhe në tjetrën Kupën e Shpëtimit.




E dymbëdhjeta është Mbretëresha e Shpresës, e udhëhequr nga feniksi (i cili mendohej se rilindte nga hiri i tij) dhe nga drita e llambës.



E trembëdhjeta është Mbretëresha e Dashurisë që mban në duar një zemër.



E katërbëdhjeta është Mbretëresha e Pendimit që mban Balsamin e Virtyteve.



E pesëmbëdhjeta është Mbretresha e Fesë që mban Diademën dhe Çelësat e Njohjes së Shenjtë të Zotit.




Këto dhe shumë Vizione të tjera të shumta dhe eksperiencia mistike iu treguan nga Zoja Këngëtarit më të madh të Rruzares, të Lumit Alano i Rupes.

Kap. XII:

VIZIONI I VËLLAZËRISË SË RRUZARES

(ilustrime nën kujdesin e Elena Bia)




Zoja e Rruzares më tregoi në Vizion origjinën e Vëllazërisë së Rruzares.

Pashë Shën Domenikun, dy vjet pas vizionit të lavdishëm të Tolozës në Francë, që i binte kryq e tërthor tokave të Spanjës, pak para se të lindte Urdhëri i Shenjtë i Predikuesve.



Ndodhi që jo larg nga Shën Jakobi i Kompostelës ai dhe shoku i tij i pelegrinazhit Fra Bernardi ranë në duart e piratëve.



Dhe, pasi i grabitën të dy dhe i torturuan, i dërguan te rremat. Ata duruan me shumë kurajo çdo gjë pa pushuar asnjëherë ditë e natë së thëni lavdet e zakonshme të Zotit.



Kishin kaluar tashmë tre muaj kur ja, erdhi një natë e frikshme: vërshuan erërat dhe u lëshuan me fuqi mbi det; shpërtheu një stuhi e tmerrshme, vetëtinin vetëtimat, gjëmonin qiejtë; thellësitë e detit ishin tronditur dhe çfarëdo gjëje që bënin armiqtë me purteka, rrema dhe çdo përpjekje tjetër, nuk arrinin dot asnjë rezultat, dhe në fund, të dëshpëruar, qanë fatin e hidhur.





Një natë tjetër, pas natës së stuhive, (ishte nata që paraprinte Festën e Zojës Nunciatë), dhe Shën Domeniku përpiqej që t'i nxiste të kërkonin Ndhimën e Zotit, Shpëtimin e Jezusit dhe Ndhimën e Marisë.

Por ata nuk deshën ta dëgjonin, përkundrazi e rrahën, derisa një dallgë shumë e madhe theu direktun e anijes dhe të gjithë piratët ranë në ujë, përveç Shën Domenikut dhe Fra Bernardit që mbetën për mrekulli mbi mbeturinat e anijes.






**Dhe ja Shenjtja Mari iu shfaq Shën Domenikut, duke i thënë:
“Domenik, për lutjen tënde për shpëtimin e këtyre të
dëshpëruarve u ofroj atyre zgjedhjen: ose të vdesin të
dëshpëruar përjetësisht, ose të pranojnë Ruzaren time dhe të
bëjnë një jetë të drejtë, duke filluar, bashkë me ty, që do të jesh
themeluesi, një Vëllazëri, që do t’i titullohet Jezusit dhe Marisë.**

**Nëse të dëshpëruarit do ta pranojnë, bëj shenjën e Kryqit
mbi det dhe stuhia do të qetësohet.**


Unë do të pajtoj Birin tim me ta.

**Përndryshe, vetëm ti dhe vëllai yt do të përparoni mbi
ujëra dhe do të dilni nga deti: ndërsa të tjerët do të gëlltiten
nga Ferri. Thuaju atyre me siguri këto që po të them”.**



Atëherë Shën Domeniku u tha atyre fjalët pikërisht siç ia kishte dorëzuar Zoja dhe qetësoi stuhinë vetëm me një shenjë Kryqi dhe me disa fjalë.

Dhe ja që, unanimisht, përgjërues, thanë që do të kishin ndjekur urdhërat e Shenjtes Mari.




Ata prematuan që do të kishin braktisur jetën e kaluar, plot mizori dhe krime të shëmtuara, dhe donin të përshkonin udhën e shpëtimit; morën nga dora e liruesit të tyre Rruzaren, e morën në dorë dhe u bashkuan të gjithë së bashku në Vëllazërinë e re që kishte Flamurin e Jezusit dhe të Marisë dhe titullin e Rruzares.

I shikojte të kërkonin falje dhe ndihmë, thellësisht të përrulur mes lotësh dhe të mbuluar me veshje të shkatërruara, që afroheshin tek këmbët e Shën Domenikut, ndërsa ai i nxirrte jashtë nga uji.

Dhe ja që, papritur, të gjithë patën vizionin e një skenari qiellor: Virgjëra Mari, Nëna e Hyjit qëndronte mbi të gjithë, e shkëlqyer me një dritë flakëruese dhe u tha njerëzve të shastisur nga mrekullia: “O njerëz me fat në këtë fatkeqësi! Kështu Unë do të shpëtoj të gjithë ata që do të mirëpres nën Flamurin e Rruzares sime”.

Dhe, duke parë drejt Qiellit, u zhduk.

Në të njëjtin moment, ata u zgjuan nga ekstaza dhe panë një copë plazhi që qëndronte në mes të detit dhe e ankoruar aty ishte anija e tyre dhe ata ishin mbi të: ishin të mahnitur nga fakti që përpara ajo ishte e shkatërruar nga ujërat, e copëtuar, e shqyer, e tmerrshme, tani në çdo pjesë ishte e paprekur, e plotë dhe e pikur.



Ata qëndronin të mrekulluar, të habitur dhe të heshtur në atë pikë, si në një port, duke vështruar qiellin dhe detin përreth tyre: dhe ja që, një dallgë e lehtë, duke përkundur ëmbëlsisht anijen, e ngriti përsëri dhe e bëri të notojë.

Atëherë, Ati, Shën Domeniku tha: “Ja, Shenjtja Mari e Ndhmës na ka dhënë përsëri bagazhet, mallrat dhe çdo gjë tjetër që ju hodhët nga anija gjatë përmbytjes”.

Atëherë, rreth e rrotull, larg, në errësi, u ngritën ca ulërima dhe ankime të demonëve: “Të mjerët, të mjerët-thërrisnin- Të mjerët ne! Ky Domeniku na shkatërron dhe gjithmonë na torturon. Ah, ne të mjerët! Na vjedh plaçkën tonë, liron skllëvërit: vë të burgosurit tanë në mes të të liruarve të tij dhe ah ne, na lidh me zinxhirë me Rruzaren e tij, na fshikullon me këtë kamxhikun e tij prej litari, na vendos në burg në mes të të burgosurve dhe na syrgjynos të lidhur me zinxhirë në fund të ferrit. Të mjerët ne!”

Kap. XIII: 1470 p.K.,

DOUAI: MIRATIMI I VËLLAZËRISË SË RRUZARES



Nga 1470 deri në 1475, fillova të mbledh frytet e para të mundimeve të mia: me 15 maj 1470, Mëkëmbësi i Përgjithshëm i Kongregacionit të Hollandës, Atë Gjovani Excuria pranoi kërkesën time të miratimit të Vëllazërisë së Douait që unë kisha themeluar në 1464, në të njëtin vit në të cilin pata shfaqjet e Zojës së Rruzares.

Në 1475 mora pjesë në Lille, në Këshillin e Kongregacionit të Hollandës dhe me atë rast vizitova Vëllazërinë e Rruzares në Douai, ku për tetë ditë u predikova anëtarëve të Vëllazërisë mbi bashkimin shpirtëror të të regjistruarve në Vëllazëri dhe mbi nevojën e regjistrimit në një regjistër të çfarëdo Vëllazërie, për të marrë pjesë në meritat e tërë Vëllazërisë së Rruzares.

Regjistri i Vëllazërisë është, në fakt, si “Libri i Jetës”.

Recitimi i përditshëm i Rruzares nga të regjistruarit në Vëllazëri i fut në një rrjet të fuqishëm solidariteti shpirtëror, duke qenë lutjet e tyre të bashkuara nga vetë Shenjtja Mari.

Falja që unë predikoja ishte shumë e madhe (dhjetë mijë vjet), si edhe mbrojtja e Shenjtes Virgjër, jo vetëm nga mëkatet vdekjeprurëse, por edhe nga: “rrufeja, bubullima, banditët, hajdutët, vrasësit, të gjithë armiqtë e ferrit”, dhe e

gjitha kjo pa shpenzuar asgjë.

Vëllazëria, për Statut të Marisë, e ka patur gjithmonë të ndaluar mbledhjen e parave: është komplet falas.




Vëllazëria që për mua si një frymë jetësore, një gëzim i thellë, e ndjeja si shtëpinë time dhe ishte për mua koha e një gëzimi të brendshëm të madh: edhe në vazhdim, kur mundesha, kthehesha përsëri tek ajo dhe më pëlqente shumë të tregoja, bashkë me Vizionet e mëdha të Zojës së Rruzares, edhe për Mrekullitë që bënte Rruzarja, nëpërmjet shembujve të disa njerëzve që me anë të Rruzares fitonin mbi errësirën e jetës dhe dilnin në dritë.

Kap. XIV:
SHEMBUJT E RRUZARES TË
TREGUARA NË VËLLAZËRI


(ilustrime nën kujdesin e: Letizia Algeri)




Shembulli i Kryediakonit Adriano që Rruzarja e ngre nga rënia e tij tragjike.



Shembulli i mësuesit të shkollës, i liruar në mënyrë të jashtëzakonshme nga burgu, falë Rruzares së Virgjëres së Lavdishme.



Shembulli i ushtarit të pathyeshëm breton.



Shembulli i një Ipeshkvi që kishte marrë pjesë në herezinë e albigjezëve dhe që u kthye falë Rruzares së Marisë.



Shembulli i Xhakomo fajdexhiut.




Shembulli i kthimit të mrekullueshëm të paganit Eliodato, falë Rruzares së Virgjëres së Lavdishme Mari.



Shembulli i Alanit, ushtar i devotshëm breton.



Shembulli i Kontit Bartolome të Italisë.



Shembulli i Kardinalit të devotshëm të Rruzares.




Shembulli sesa e dobishme është edhe vetëm mbajtja e Rruzares së Virgjëres Mari.




Shembulli i Rev. Atë, Fra Pjetrit, epror certozin.



**Shembulli i Shfaqjes së mahnitshme të Virgjëres Mari mua,
Alanit të Rupes, Dhëndrit të saj të ri.**



Shembulli i murgut i bërë papritur i ditur.



Shembulli sesa e dobishme është lutja e Rruzares së Virgjëres së Lavdishme, duke përdorur dënimet trupore.




Shembulli mbi Rruzaren që të bën të fitosh Qytetin e Qiellit.



Shembujt e shkurtër të Ati ynë dhe Të falemi Mari.



Shembulli i Baronit Pjetër.



**Shembulli i Kontit të mbrapshtë të Francës, të kthyer nga
forca e Ruzares së Virgjëres Mari.**




Shembulli i kthimit të një fisniku dorëlëshuar.



**Shembulli i Rruzares që shpëton një pirat nga një djall,
nën veshjen e një shtëpiaku.**



Shembulli i Vëllait Laik që recitonte vetëm lutjen “Të falemi Mari”.



Shembulli i Princit Alfons.



Shembulli i mrekullisë së të bukurës Katerina, romane.



**Shembulli i pasqyrës së mëkatarës Benedeta, nga
Firence.**




Shembulli i Benedetës së Spanjës.




Shembulli i virgjëres Aleksandra.



Shembulli i fisnikes Luçia të Spanjës.



Shembulli i Marisë, Konteshë e Spanjës.



Shembulli i murgeshës së klauzurës dhe të Manastirit të reformuar, falë Ruzares.



Shembulli i Elenës, gruas së përdalë të Anglisë që kthehet falë Rruzares së Virgjëres Mari.



Shembulli i paharrueshëm i Konteshës Domenika.



**Shembulli sesa të mira ka për gratë e martuara të lusin
Rruzaren e së Lumes Virgjëres Mari.**



Shembulli i virgjëres së shqyer nga një ujk.



Shembulli i tre motrave që vdiqën në mënyrë të shenjtë.



Shembulli i italianes Mari që nuk donte të luste Rruzaren dhe të bënte pjesë në Vëllazëri.



Shembulli i murgeshës së devotshme, falë lutjes “Të falemi Mari”.

Kap. XV: 1471 p.K.,

ROSTOCK, DOKTORATURA DHE MËSIMDHËNIA.

(ilustrime nën kujdesin e: Elena Bia)



Në vitin akademik 1470-71, në Rostock, unë përfundova vitin e doktoraturës në Teologji dhe me 4 shtator 1471, u bëra Doktor dhe Mjeshtër në Teologji, duke komentuar librat e Gjykimeve të Pjetër Lombardit dhe duke diskutuar tezën mbi Dinjitetin e Përshëndetjes Engjëllore, domethënë të lutjes “Të falemi Mari”, me titull: *Principium super III Sententiarum*.

Në Rostock, lidha miqësi me Certozën e Marienehe, në veçanti me certozinët Jacques Carto e Jean Spane, të cilëve u kisha dorëzuar disa nga shkrimet e mia mbi Ruzaren që ata i publikuan pas ikjes sime nga kjo botë.

Kap. XVI:

**MUAJT E FUNDIT TË JETËS: QERSHOR
1475: TAKIMI NË TOURNAI ME
IPESHKVIN FERRIKO DHE
DORËZIMI I APOLOGJISË SË
RRUZARES.**




Në fund të qershorit të vitit 1475, pasi u predikova ushtrimet vëllezërve të Vëllazërisë së Douait, shkova në Tournai, jo larg nga Douai, për të takuar Ipeshkvin Ferriko dhe për t'i dorëzuar *Apologjinë e Rruzares*, si justifikim për kritikën që Ipeshkvi më kishte bërë: në udhën e Provanisë Hyjnore, ai që më dukej si një sulm i padrejtë ndaj mirësisë së veprës që po çoja përpara prej vitesh, ishte bërë rruga për t'i bërë të njohur botës mendimin tim.

***Apologjia e Rruzares* ka qenë i vetmi libër i publikuar nga unë, pjesa tjetër e veprave është publikuar pas vdekjes sime, nga miqtë e mi certozinë dhe domenikanë që kanë marrë letërkëmbimet e mia të shumta dhe i kanë shtypur.**

Menjëherë pasi shkova tek Ipeshkvi Ferriko, vizitova miqtë e mi certozinë të Hérines, dhe në veçanti eprorin e tyre Lorenzo Musschesele.

Para se të filloja vitin e ri shkollor në Rostock, ndalova pastaj për ca kohë në Gand, duke vazhduar pastaj deri në Kuvendin domenikan të Zwolle.

Kap. XVII:
ZWOLLE, 15 GUSHT 1475:
KËNGA E MJELLMËS



Me 15 gusht 1475, pas tërheqjes në Vëllazërinë e Douait dhe dorëzimit të Apologjisë Ipeshkvit Ferriko, shkova në Kuvendin domenikan të Zwolle për të pushuar pak, para se të filloja vitin universitar në Rostock.

Por misioni im mbi tokë kishte mbaruar: në Festën e Ngjitjes në Qiell të Shenjtes Mari, u sëmura papritur dhe Zoja më paralajmëroi vdekjen time dhe më tregoi në vizion Ngjitjen e saj të Lavdishme në Qiell.

Kap. XVIII:
VIZIONI I NGJITJES NË QIELL TË MARISË DHE
DHE TË FILLIMIT TË PERANDORISË SË SAJ TË
MËSHIRËS




Ditën e Festës së së Lumes Virgjëres Mari ngjitur në Qiell, pasi mora Sakramentin Qiellor, papritur ndjeva që po përshkoja Qiellin dhe admirova Ngjitjen e mrekullueshme të Virgjëres Mari, e cila hidhej me gatishmëri të mrekullueshme në krahët e Birit dhe Dhëndrit Jezu Krisht, në praninë e Kishës triumfuese.

Dhe shpërthyen Gëzimet e Qiellit, ndërsa Radhët Qiellore e takonin dhe, duke përkulur gjunjët, me një harmoni të papërshkrueshme melodike, brohorisnin me Të falemi Mari, që shoqëronte Triumfin Qiellor mes nderimit të thellë, haresë dhe madhështisë së të gjithë Qiellit.



Nuk shihej asnjë Krijesë Qiellore pa Psalter-Rruzaren muzikore dhe dëgjohej vetëm oshëtima e Të falemi Mari, në një melodi të ëmbël dhe të magjishme.



Shën Mikeli Kryeengjëll drejtonte si Muzikant dhe përreth tij ishin 150 koncertistë.

Ajo këngë dukej pikërisht sikur ngrinte lart Zemrat!



Nga Veriu dallova një Humnerë të një thellësie të pafundme, nga e cila ngrihej zjarr dhe tym i zi, që sillte shkretim në botë.



Dhe dëgjova, atëherë, zërin e një Shqiponje që fluturonte dhe bërtiste: “Mjerë, mjerë bota që do të digjet e gjitha”.



Pashë pastaj turma të panumërta demonësh, që me tre kamxhikë bënë të rrokullisej në humnerën e Ferrit të frikshëm me 150 Furra pothuaj të gjithë botën, mes torturash të pafundme të çdo tipi.

Atëherë Mbreti Jezus, pasi bëri të ngjitej Mbretëresha e Qiellit mbi Korët e Engjëjve, i tha kështu: “Nëna ime, Nuse e Virgjër dhe Mbretëreshë, është momenti t’i prezantojmë Trinisë së Shenjtë Meritat e tua, sepse i ke ardhur në ndihmë botës. Do të marrësh në zotërim, në fakt, Mbretëritë Qiellore”.



U shfaqën pastaj pesëmbëdhjetë Mbretëresha madhështore: dhe përreth secilës qëndronin Shoqërueset e veta.



Maria u vendos Perandoreshë e tre Perandorive të përjetshme në Qiell dhe Mbretëreshë e pesëmbëdhjetë Mbretërive, dhe po krijonte me lumturi Perandorinë e saj të Mëshirës.

Kur ja, po çoheshin peshë me tërbim nga ana e kundërt, tre Perandori të tjera, të ardhura nga bota e njeriut, bota e rënë dhe pushtuar Zotit, dhe dukeshin sikur ngriheshin kundër Mbretërive të reja të Mëshirës së Zotit dhe të Nënës së Hyjit.

Prandaj tre Mbretëreshat e kësaj Perandoreshe, Fuqia, Drejtësia dhe e Vërteta, të mbledhura thanë: “Zotëruesja Mëshirë vetëm do të drejtojë çdo gjë? Po lëshuam pe do të vdesim. Po u shkatërrua Ligji, do të pushojë Fuqia dhe Drejtësia e Zotit mbi të këqijtë, si edhe Gjykimi i Vërtetë i Zotit për dënimin e të këqijve. A duam pra ta luftojmë?”

Ky propozim u pëlqye shumë nga të gjithë.


Por ato ranë në këmbët e Marisë dhe nga Qielli u bë një shpallje: “Kushdo në Psalterin-Rruzaren e Krishtit dhe të Marisë do t’u shërbejë besnikërisht Atyre në pesëmbëdhjetë Mbretëritë, nuk do t’i nënshtrohen Perandorisë së tre Mbretëreshave të tjera, tashmë të mundura: por do të shijojë lumturinë e plotë në Mbretërinë ekskluzive të Marisë”.

Këtyre gjërave Trinia e Shenjtë u shtonte: “Kështu qoftë dhe kështu ndodhtë në përjetësi”.

Të gjithë Shenjtërit shpallnin me zë të lartë: “U bëftë kështu, ndodhtë kështu. Amen, amen”.



Perandoresha e rënë, shtoi: “Sigurisht o tre herë e Lumja Mari, Perandoreshë e denjë, Mbretëria jote do të jetë shumë e vogël, e jona shumë e madhe, pasi një pjesë shumë e vogël do të përkulet nën flamurin e të luturit, të të mbajturit dhe të të përhapurit të Rruzares. E ngushtë, në fakt, është Udha që të çon në Qiell dhe pak do të hyjnë me anë të saj. Pjesa më e madhe rënkon, është e skllavëruar dhe pastrohet nën zgjedhën tonë dhe ky pastrim është i pareshtur”.



Pas njëzet ditë sëmundjeje, u shuajta me emrin e Marisë në gojë, me 8 shtator 1475, në moshën 47 vjeçare. Shenjtja Mari më qëndroi pranë në kalimin nga kjo jetë, duke më mbajtur për dore, ndërsa shtrëngoja Kurorën e Ruzares.



U varrosa në Kishën e Domenikanëve, në Zwolle, ngjitur me Kuvendin në të cilin vdiqa. Poshtë dyshemesë së Kishës, që sot nuk është më e kushtuar, është akoma i pahapur, varri im. Një ditë kjo Kishë do të bëhet Shenjtërorja e parë kushtuar mua.



“Çfarëdo gjëje që do t’i kërkonit Marisë në Ruzare dhe në Vëllazërinë e saj, ajo do t’ua japë”

(I Lumi Alano i Rupes).